

DHURATA KASA

GRANTI

roman

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktor letrar: Behar Gjoka

Kopertina *dhe* përkujdesja grafike: Erdita Oshafi

ISBN 9789928817686

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha" nr. 71, Tiranë 1023.

Kutia Postare 1420

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al/>

KAPITULLI I

Atë mëngjes vjeshte, të lagur nga shiu, ishte pikërisht Simfonia e Pestë, e ashtuquajtura “Simfonia e fatit e Bethovenit”, e cila e shkundi Grantin duke i kujtuar vuajtjet, përpëlitjet dhe zvarritjet që kishte bërë për të dalë mbi afeksionin kohor momental të ngazëllimit zyrtar që po jetonte. Ashtu si mjeshtri Bethoven në 1804-1808 përreth katër vjet, në një vetmi të plotë, gati marramendëse, kishte punuar skica dhe partitura të pafundme për të realizuar këtë simfoni, gdhendur me një verbëri të jashtëzakonshme, edhe ai si zv/ministër i Ekonomisë, kishte bërë gjithçka, sa kish në dorë për simfoninë e jetës së tij të kaluar në nota të larta e të ulëta, derdhur në kohë të ndryshme muzikore Alegro, Andante, Skerco Alegro, e zymtë e tensionuar e në fund prapë Alegro mbi një realitet ngadhënjyes dhe të mistershëm. Këtu filloi pikërisht ngritja e tij, kulmimi dhe fuqizimi, krejt i beftë.

Zëri i sekretares e shkundi nga mendimet e ndryshme, që po përthithte bashkë me puron *Amaros*, e cila e njoftonte për mbledhjen e orës nëntë me ministrin. Veshi me nge, pa asnjë ngutje, xhaketën *Hermes*, një kashmir ngjyrë blu me prerje slim-fit. Granti ishte ai tip mashkulli, që kurrë nuk nxitonte për

llogari të të tjerëve, kështu që sërish u ul të mbaronte puron duke bërë një telefon.

- Alo baby si je? Jam i dërrmuar nga mbrëmë, sonte jam andej nga ti.

- Mirë, - u përgjigj zëri i lodhur i një femre lolitë nga ana tjetër, i cili dukej sikur më shumë nuk e ftonte, - por mos harro, merr me vete edhe trutë, sepse zakonisht kur vjen tek unë i lë diku tjetër.

- Jo kaq vrazhdë e dashur, ti ma kupton ngarkesën apo jo? Megjithëse, flasim kur të vij aty.

- Si të duash, unë e lodhur që e lodhur jam nga ti, punërat e tua, politika, biznesi, dreqi e ku di unë - femra nga ana tjetër e telefonit kuptohej që jo vetëm nuk e mirëpriste por edhe e akuzonte për menefregizmin dhe indiferencën mashkullore. E kë, pa? Atë, Grantin, atë që i kishte siguruar asaj çdo gjë, diplomën, punën, apartamentin, kafet e përditshme, madje edhe ajrin që ajo thithte në hapësirat e kullës ku punonte e jetonte, pa e vrarë mendjen por duke shfrytëzuar mundësit që ai i kishte krijuar. Ai e mbylli telefonin duke skërmitur dhëmbët, tha me vete “Kuçka”. Telefonatën e dytë, po me atë qetësi olimpike, ndonësë me pak drojë, e bëri me gjyshen e tij e cila jetonte diku në fshat vetëm.

- Alo, aloooo! - Parua, gjyshja ishte tetëdhjetë e pesë vjeç, gjithmonë e qortonte, kuptohet ato herë që mund të fliste me të, sepse ky i kishte i rralluar kontaktet siç thoshte ajo: “Që kur u bë i madh s’e çante kokën për të, ajo që e futi në rrugë të mbarë, tani nuk i fliste asaj që e kishte rritur me pekule, duke i fshirë qyrrat e duke i larë bythën që në vogëli e derisa u bë me shkollë” - ja me këto fjalë e shante Paro me vete, e

ca ia thoshte, e ca nuk ia thoshte. Gjyshja Paro, tipike një plakë e jugut, jetonte në Voloros, fshat i gurtë në rrethinat e Gjirokastrës. Ajo e kishte marrë që të vogël, motak për ta rritur vetë, meqë i biri kishte punëra të mëdha në Tiranën e rrëmujshe, ku sipas Paros nuk e merrte vesh njeriu njerinë, dhe as i pari të dytin. Edhe emrin ajo ia kishte vënë, gjithmonë e përmendte me krenari këtë. Kishte marrë në telefon në postën e fshatit, se atëhere s'kishte telefon si sot, dhe kishte uruar djalin bashkë me vënie e emrit, Granit, që do të thoshte gurë i fortë dhe i bardhë, karakteristikë e atyre zonave. Në një farë mënyre ky gur identifikonte tërë krahinën, e cila mbahej me nxjerrjen dhe latimin artizanal të tij. Pastaj, plaka donte t'i vinte një emër të pavënë më parë në fisin e tyre, dhe në fakt të gjithë u habitën me emrin. - E po është im nip, - u thosh të tjerëve, - nga ky gur ka dalë e unë nuk e le të shpëtojë nga ky truall. Dikush, si me shaka, tha se plaka ishte roitur, dikush tha se ishte tamam ashtu siç e etiketonin Paron, të habitshme, paksa e shkarë, dikush mbase kërkoi edhe në legjenda të lashta, por askush nuk i ra në të kuptimit të vërtetë që kishte emri, thjesht gurë i fortë.

Paro kishte qenë gjithë jetën një grua e sertë, që e pati shkuar jetën, me një burrë po aq të dreqosur, jo shumë të egër por grindavec i madh. Ata, si çift ishin si gozhda me çekiçin, ashtu si çekiçi nuk ekziston pa thumbin e gozhdës, ashtu edhe gozhda nuk është funksionale pa goditjen e çekiçit. Pra, tërhiq e mos e këput. Parua ua kishte psonisur psikologjinë njerëzve të burrit, që në krye të ditës së parë, siç thonin nga

ato anë, prandaj zgjodhi të njëjtën mexhite, kokë për kokë, i egër guri i vendit, e egër edhe ajo. Vetëm diçka nuk i falte vetes, keqedukimin e të birit, Halimit, siç mërmëriste shpesh me vete. Parua, si grua sqimatare, kishte një ndjesi të veçantë për njerëzit, vendin, zakonet, gurët, e për gjithçka që e rrethonte, veçori që rrallë e nxirrte në pah dhe e bënte të dukshme. Pasi parashikonte në të gjitha mënyrat, fjalën e fundit e thoshte të parën. “Kështu i do mushka drutë” e mbyllte gjithmonë logjikimin përvëlues plaka. Ndaj nuk e zgjati shumë, pasi foli me të birin në postën e fshatit, kërkoi nusen:

- Nuse bëje Granitin motak, hiqi sisën e ma sill se do ta rris vetë, - kaq tha Parua dhe u tha u bë.

- Alo, alo? Hë moj Paro, hape të shkretën, - fliste me telefon në dorë Granti duke dalë nga zyra, por edhe duke përshëndetur kolegët nëpër korridore. E mbylli telefonin dhe u drejtua nga dera e ministrit. Ishte i përgatitur për përplasjen që do të ndodhte. Kishte një jetë, vite, muaj e tashmë vetëm disa ditë e ndanin nga shndërrimi i rëndësishëm për t’i vërtetuar njerëzve dhe botës, se ai kishte arritur atje ku duhej, nën çadrën e madhe kineze, e cila do t’ia mbulonte mëdyshjet, konfliktet, komplotet, përplasjet por jo nga shiu, por nga nxehtësia, të shkuarat e frikshme të cilat nën ombrellën e pushtetit do të treteshin dhe konvertoheshin. U fut përsëri në zyrë me një ecje elegante, që e karakterizonte. Gjatë përpjekjeve të tij, për ndryshim, Granti i qe përkushtuar shumë edhe përsosmërisë së vetes, shijeve, kalimeve të ndryshme luajale, por duke këmbëngulur që gjithmonë në

fund të çdo procesi të ishte ai. Statura trupore nuk i mungonte, ishte gati dy metra i gjatë, një trup i drejtë, i lidhur natyrisht, shpatullgjerë dhe me muskuj të formësuar. Ai nuk harronte kurrë, që pas çdo ngarkese psikologjike, të bënte stërvitjen e tij shkarkuese në palestër, ku shkulmet psikologjike përziheshin vrulltas me ato fizike. Më shumë përkujdesje, në fakt kishte treguar edhe Bea, sepse ata frekuentonin bashkë të njëjtën palestër, aty ishin njohur. Ajo ishte interesuar edhe për trajtimin e tij, paksa më vonë në një SPA dhe për kurimin e tij me një stil tjetër veshje nëpër atelietë e vogla që sapo kishin filluar të mbinin diku përreth bllokut. Granti ishte një mashkull që binte në sy shumë larg, por ai donte tjetër gjë tani, kërkonte një vëmendje të shtuar administrative por jo politike. Tashmë ky ishte parimi i vetëm i tij, fuqizohu nën hijen e politikës, shërbeji asaj por pa u bërë pjesë e dukshme. Pikërisht me këto mendime, që shpesh rrëshqisnin në meditime po futej në atë zyrë.

- Eja Grant, - i foli ministri duke i zgjatur dorën drejt kolltukut, - se mbase s'kemi shumë kohë dhe duhet të flasim për një çështje adekuate por edhe mirëkuptuese.

Granti u çudit me tonin e mirësjelljes dhe gjithçka iu ravijëzua në memorien e tij. Kishte dy mundësi ose ky pusht po e lëshonte karrigen me një urdhër të prerë, gjë që ishte tipike për kohën dhe administratën e monokomanduar ose po bënte lojën e Kapo-barones së Italisë së viteve '50-'60, e cila kishte një moto: "vrit duke provokuar". Ruajti seriozitetin, nuk foli fare, por damari që nganjëherë i bëhej jeshil i ngrit

mbi lëkurën e gushës. Në këtë kohë i ra telefoni. Ishte Parua, “dreq plake”, murmuriti me vete dhe mbylli telefonin. Ta dinte Parua që e kishte sharë nën dhëmbë nuk do t’ia linte mangut jo. “Kopil, prandaj të bëra kaq? Gremisu!” Qeshi me vete, por zëri i ministrit e kthjelloi.

- Po të doni mund të flisni, - ia ktheu vëmendjen ministri, që ishte skuqur e bërë si “mangalli i Terziut” kur thoshte Parua.

Jo, jo! - këmbënguli Granti duke qëndruar në këmbë si gjahtari para presë së vet. E kishte imagjinuar këtë skenë, por jo kaq shpejt. Iu kujtua gjahtari i kodrës së Verries, e vetmja kodër e Volorosë e gjelbëruar ende, ai ta vinte syrin që një vit para, e pikaste dhelprën, lepurin ose derrin e egër, i gjente vendkalimin dhe matej disa herë, matje që mund të shkonte disa muaj. Kur plaku Bano, ia rrëfente Granti përfytyronte veten dhe betohej e stërbetohej se ai do te ishte gjahtari me i shpejtë. Tani, me ministrin përballë ia kishte arritur qëllimit, në një kohë vetëm dy mujore dhe në një luftë të heshtur, që ngjasonte me luftën nënujore të kafshëve të ujit, ai kishte fituar.

- Kështu, unë po largohem në një detyrë tjetër, por doja të ta komunikoja personalisht për vetë kohën që kemi punuar bashkë dhe për të qenë korrekt. Ky është një urdhër i miratuar paraprakisht nga lart, pritet vetëm dekretimi, - këtu goja i ngeci si një gagaç i marrë fund. Grantin as nuk e preku e as nuk i bëri përshtypje qurravitja e tij, pasi gjithmonë kishte qenë një zyrtar që bënte të fortin nga poshtë dhe langaraqin nga lart. Por kuptoi një gjë të rëndësishme,

që në jetë ka më shumë rëndësi ikja se ardhja dhe iu kujtua një leksion në mikroekonominë e Hal Variant, i universitetit të Michiganit “në qoftë se ne njohim kurbën e marrëveshjes, atëherë çdo këmbim do të përfundonte diku në kurbë, sidoqoftë ne nuk e dime se ku”. Për të njëmijtën e sekondës, Granti u mundua të kuptonte këtë ikje, se cilës pikë të kurbës i përkiste kjo marrëveshje këmbimi, krejt e pritshme. Ai kishte marrë vetëm një sinjal për këtë këmbim, por sheshpamjet e asaj çka pritej prej tij, konkretisht nuk i kishte qartësuar ende. Kjo ishte përpos ambicjes së tij, për t’u ngjitur në atë çadrën e famshme kineze, e cila hapej me lehtësi, por për t’u mbyllur varej nga paktet dhe rrugët qorre, të pashmangshme. E në këtë pikë Granti nuk qëndronte shumë prapa, pasi ai ishte dhëlpër e lindur e marrëveshjeve të tilla, ku nuk harronte të tërhiqte gjithmonë nga vetja. Jo më kot, në një moshë aq të re ai kishte drejtuar një nga bankat më në zë në qytet, madje duke zotëruar 10% të aksioneve të saj, jo më kot kishte gllabëruar së fundmi një çmim mbi politikat ekonomike të dhjetëvjeçarit të parë të Shqipërisë në tranzicion, jo më kot nën heshtje nëpërmjet të tretëve kishte blerë firmën e eksportit të mermerit e granitit.

E përsëri kurba e marrëveshjes nuk i ikte nga imagjinata, e mundonte ideja se cila ishte pika kulmore e marrëveshjes në këtë kurbë? Kujtoi telefonatën e papritur nga “shefi”, gjë e rrallë kjo, pasi ai fliste gjithmonë nëpërmjet këshilltarit të tij:

- Grant a je gati për postin e ministrit? Më thuaj shkurt dhe qartë. - Përgjigjja ishte më e befte se mendimi.

- Po shef, nëse ju keni nevojë, gati jam. Dhe ai priste, e priste me ditë, me orë duke thithur puron e tij Amaros, që çuditërisht i fillonte dhe i mbaronte më shpejt se 24 cigare bashkë. Brenda një muaji, me vullnet të hekurt, kishte stabilizuar punët e tij private. Kështu i kishte dhënë udhëzime të qarta drejtorit të firmës, për lidhjen e kontratave të reja, sidomos me tregun amerikano-latin. Kishte planifikuar blerjen e 5% të aksioneve të reja, përmes përfaqësuesit të tij, të cilit i kishte kaluar menaxhimin e bankës, si dhe kishte njoftuar partnerin e tij Italian, Gaetanon se do të mungonte për ca kohë. Trokitja e derës ia përqëndroi shikimin instinktiv te tavolina ku sekretarja po vendoste kafetë. Prapë iu kujtua Parua “kafaja në shoqëri është për të vdekurit, ne shqiptarët kemi rakinë për mort e glikonë për gëzime”, i molloiste ngahera kur Granti e shikonte me xheze në hi. Kafënë e pinte vetëm vetë. Edhe sot e blinte kokërr e kur nuk kish gjetur nja dy herë ia rrokoniste kokën në tel Grantit, i cili ia dërgonte me të njohur. E piqte si në kohë dhe e bluante me mullirin e burrit që ia kishte bërë dhuratë në martesë, të cilit vende-vende i ishte rrjepur bakri që e vishte, megjithatë ajo e lante e pastronte dhe e vinte përsëri në kuti. I dukej sikur ruante një amanet. Pastaj ulej e pinte kafënë vetë dhe vetëm. Buzëqeshi para se të pinte kafënë, kjo iu duk si ngushëllim për ministrin, i cili i shpjegonte se për arsye personale kishte kërkuar largimin dhe se kishte kohë që po e priste një lëvizje të tillë. Granti e duroi me seriozitet derisa mbaroi rrëfimin e kotë, pasi ai dinte saktë dhe shkurt sesi i erdhi fundi ministrit. Tashmë, ai ishte një lojtar jashtë